



DHE ZHVILLIMIT RURAL
Nr. 7156 Prof.
Datë 21. 10. 2021

REPUBLIKA E SHQIPĒRISĒ
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 608, datë 20.10.2021

PËR

**PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE
TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufutorë.
3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:
 - a) Harton e zbaton politikat shtetërore për çështjet e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufutorë;
 - b) Harton e propozon miratimin e projektakteve për përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, veterinarisë, peshkimit dhe akuakulturës me normat e kërkesat e Bashkimit Evropian, miraton projektaktet që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë, si dhe vlerëson nevojat e planifikon fondet e nevojshme për zbatimin e tyre;

- prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë;
- c) Ndjek përgatitjen e strukturave të saj për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të Komisionit Evropian për zhvillimin rural, harton e zbaton programin IPARD, në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian;
 - d) Zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët, agrobizneset dhe peshkatarët, bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre;
 - dh) Harton e zbaton politika për miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë;
 - e) Harton e zbaton politika për menaxhimin e qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmbytjet;
 - ë) Harton e zbaton politikat për ushqimin, sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;
 - f) Harton e zbaton politikat në fushën e veterinarisë, për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, epidemiologjinë, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe lëvizjet e tyre, me qëllim garantimin e shëndetit publik veterinar;
 - g) Harton e zbaton politikat në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe luftimit të dëmtuesve;
 - gj) Bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe të kullotave;
 - h) Harton e zbaton politikat shtetërore për peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri dhe menaxhimin e burimeve peshkore;
 - i) Harton e zbaton politikat e zhvillimit rural, agroturizmit, standardeve cilësisë, produktet organike, si dhe cilësinë e jetës në fshat dhe të zhvillimit rural;
 - j) Kujdeset për ngritjen e funksionimin e shërbimit këshillimor publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, si dhe nxit shërbimet digitale dhe inovacionin në bujqësi, duke bashkëpunuar me universitetet bujqësore;
 - k) Harton e zbaton politikat për marketingun agrar dhe agropërpunes. Përgatit strategji dhe projekte, duke bashkëpunuar edhe me organizma ndërkombëtarë për analizimin e zhvillimin e shkëmbimeve tregtare dhe sidomos për rritjen e eksportit të produkteve shqiptare;
 - l) Harton regjistrin e fermerëve.
4. Vendimi nr.512, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, i ndryshuar, shfuqizohet.

vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botehet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

DATË 24.10 - 2021

RURAL

DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI



The image shows a handwritten signature "Engjëll AGACI" written twice in black ink. Overlaid on the signature is a blue circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE" around the top edge and "MINISTRIA E KULTURËS" around the bottom edge. In the center of the stamp is a small emblem featuring a double-headed eagle.